




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Zyra e Kryetarit të Komunës  
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor`s Office

Date: 12.01.2024

Nr. 02/11

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas nenit 54 të Statutit të Komunës së Shtimes si dhe në pajtim me Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 19.12.2023 me nr. të prot. 02/1155 mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me komunat e regjionit të Ferizajt, Kryetari i Komunës së Shtimes merr:

V E N D I M

1. **Themelohet Komisioni komunal për bartjen e dokumentacionit përkatës, pajisjeve përkatëse, automjeteve dhe mjeteve të tjera funksionale nga Komuna e Shtimes në Agjencinë Pyjore të Kosovës.**

2. Komisioni i themeluar sipas pikës 1 të dispozitivit përbëhet nga këta anëtarë:


1. **Safet Brahimi - Kryetar;**

2. **Bujar Ferati - Anëtar;**

3. **Armend Imeri - Anëtar.**

3. Komisioni i kryen detyrat e tij në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ka për obligim të bëjë bartjen e të gjitha të dhënave dhe pajisjeve në Agjencinë Pyjore të Kosovës, sipas Memorandumit të Bashkëpunimit të datës 19.12.2023 me nr. të prot. 02/1155 mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komunave përkatëse.

4. Paraprakisht Komisioni zhvillon të gjitha verifikimet e nevojshme dhe identifikon çdo aset që duhet të bartet nën administrimin e Agjencisë Pyjore të Kosovës, përfshirë listat e stafit të punësuar, rojet e pyllit dhe të gjitha elementet e tjera sipas Memorandumit.



5. Mandati i Komisionit është i vlefshëm deri në përfundimin e procedurave të bartjes së të gjitha pajisjeve dhe të dhënave sipas qëllimit të këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Iu dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Bujqësisë

Arkivit

**Kryetari i Komunes**

**z. Qemajl Aliu**

